



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 363 Prot.

Tiranë, më 09 / 02 / 2023

VENDIM

Nr. 02, datë 09.02.2023

PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2024 - 2025**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik, neni 9, si dhe në propozimet e fakulteteve për kriteret e pranimit në programet përkatëse të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2024-2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 09.02.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit, për vitin akademik 2024-2025, në programet e ciklit të dytë të studimit, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave për të shpallur publikisht kriteret e pranimit në faqen zyrtare të UPT dhe në portalin U-Albania.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari

Maliqari
2023





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

**Kriteret e pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë në UPT,
për vitin akademik 2024 – 2025**

Kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të dytë, të ofruara nga Fakultetet e UPT-së, për vitin akademik 2024-2025 janë si më poshtë:

A. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës me programin e studimit:

1. Master Profesional në Restaurim Monumentesh Kulture

Përzgjedhja e kandidatëve në programin e studimit “Master Profesional në Restaurim Monumentesh Kulture”, për vitin 2024-2025 do të bëhet si më poshtë vijon:

- a. Kandidati duhet të jetë diplomuar në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në Arkitekturë ose në programet të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë në Arkitekturë dhe Inxhinieri Ndërtimi (Inxhinieri Ndërtimi), duke i dhënë prioritet në regjistrim kandidatëve të diplomuar në UPT, përkatësisht në: Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit (Inxhinieri Ndërtimi).
- b. Kandidatët të cilët janë diplomuar jashtë vendit, duhet të kenë kryer njësimin e diplomës pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin e lartë të Shtetit Shqiptar.
- c. Renditja e kandidatëve do të bëhet në rend zbritës në bazë të mesatares më të lartë sipas kategorive të kuotave të miratuara.
- d. Procedura e pranimit do të bëhet në bazë të udhëzimeve të MAS, si dhe rregullores së Masterit Profesional në Restaurim Monumentesh Kulture.

B. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minerave me programet e studimit:

Master i Shkencave

1. Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeoinformatikë;
2. Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogeologji;
3. Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologjia e Vendburimeve Hidrokarbure;
4. Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji;
5. Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili: Inxhinieri Minerare dhe Markshajderi;





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

6. Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili: Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve;
7. Master i Shkencave në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit;
8. Master i Shkencave në Inxhinieri e Gjeomjedisit.

Në programet e studimit “Master i Shkencave” mund të regjistrohen vetëm aplikantët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a. Zotërojnë një diplomë të ciklit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) të fituar pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minerave, në Universitetin Politeknik të Tiranës, ose diploma të ngjashme të fituara në Universitete të tjera, brenda ose jashtë vendit. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga departamenti që mbulon këtë program studimi. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti, mbështetur në:
 - parimin meritë-preferencë;
 - kuotat e pranimit të miratuara;
 - prioriteteteve të vendosura nga departamenti.Lista e fituesve shpallet në ambientet e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minerave si dhe në faqen elektronike të fakultetit.
- b. Njohin një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht, e vërtetuar kjo me dëshminë përkatëse. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj miratohet nga SAUPT, në përputhje me udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- c. Që plotësojnë kriterin e notës mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor, e cila propozohet çdo vit nga departamentet përkatëse dhe miratohet nga dekanati i fakultetit, mbi bazën e numrit të studentëve aplikantë dhe rezultateve të arritura prej tyre.

Pranimet bëhen sipas hapave të mëposhtëm:

- 1) Regjistrohen fillimisht, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor të programit të njëjtë me programin e studimit “*Master i Shkencave*”, në të cilin aplikojnë.
- 2) Në rast se, pas pranimit sipas përcaktimeve të pikës 1, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të aplikantëve që zotërojnë diplomë Bachelor në programet e tjera të studimit të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minerave, sipas shkallës së afërsisë me programin e studimit “*Master i Shkencave*”, në të cilin aplikojnë.





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

- 3) Në rast se, edhe pas plotësimit të pikës 2, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët me diplomë Bachelor (ekuivalente me programet e studimit Bachelor të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave) të fituar në programet e tjera të studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës ose jashtë tij, sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.

Master Profesional

1. Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeoinformatikë;
2. Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji;
3. Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologjia e vendburimeve të hidrokarbureve;
4. Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji;
5. Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri Minerare;
6. Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, profili Gjeomatikë;
7. Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, profili Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve;
8. Master Profesional në Inxhinierinë e Naftës dhe Gazit;
9. Master Profesional në Inxhinieri Gjeomjedisi.

Në programet e studimit "Master Profesional" mund të regjistrohen vetëm aplikantët që zotërojnë:

Diplomë të ciklit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) të fituar pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, në Universitetin Politeknik të Tiranës, ose diploma të ngjashme të fituara në Universitete të tjera, brenda ose jashtë vendit.

Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga departamenti që mbulon këtë program studimi. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti, mbështetur në:

- parimin meritë-preferencë;
- kuotat e pranimi të miratuara;
- prioriteteve të vendosura nga departamenti.

Lista e fituesve shpallet në ambientet e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave si dhe në faqen elektronike të Fakultetit.

Pranimet bëhen sipas hapave të mëposhtëm:





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

1. Rregjistrohen fillimisht, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor të programit të njëjtë me programin e studimit “*Master Profesional*”, në të cilin aplikojnë.
2. Në rast se, pas pranimit sipas përcaktimeve të pikës 1, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të aplikantëve që zotërojnë diplomë Bachelor në programet e tjera të studimit të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, sipas shkallës së afërsisë me programin e studimit “*Master Profesional*”, në të cilin aplikojnë.
3. Në rast se, edhe pas plotësimit të pikës 2, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët me diplomë Bachelor (ekuivalente me programet e studimit Bachelor të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave) të fituar në programet e tjera të studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës ose jashtë tij, sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.

C. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike me programet e studimit:

1. Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë

ka vendodur këto kritere:

- a. Kriteret e përcaktuar në nenin 76/4 dhe në nenin 76/5 të Ligjit Nr.80/2015.
- b. Kanë përfunduar studimet me notën mesatare të ponderuar jo më pak **se 6.5 (gjashtë presje pesë)**.
- c. Nëse nuk plotësohet numri minimal i studentëve për hapjen e programit të studimit, mesatarja pranohet më e ulët deri sa të plotësohet ky numër.
- d. Renditja e kandidatëve bëhet sipas notës mesatare të ponderuar.
- e. Kanë përparësi studentët që kanë diplomë Bachelor në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në UPT dhe më tej Fakultetet e tjera të UPT.
- f. Pranohen edhe studentë nga programe studimi ekuivalente në institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit të akredituara.

2. Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike

ka vendodur këto kritere:

- a. Kriteret e përcaktuar në nenin 76/4 dhe në nenin 76/5 të Ligjit Nr.80/2015.
- b. Kanë përfunduar studimet me notën mesatare të ponderuar jo më pak **se 6.5 (gjashtë presje pesë)**.
- c. Nëse nuk plotësohet numri minimal i studentëve për hapjen e programit të studimit, mesatarja pranohet më e ulët deri sa të plotësohet ky numër.





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

- d. Renditja e kandidatëve bëhet sipas notës mesatare të ponderuar.
- e. Kanë përparësi studentët që kanë diplomë Bachelor në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në UPT dhe më tej Fakultetet e tjera të UPT.
- f. Pranohen edhe studentë nga programe studimi ekuivalente në institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit të akredituara.

3. Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, profili Energjetikë

ka vendodur këto kritere:

- a. Te kene perfunduar studimet Bachelor ne Inxhinjeri Elektrike me noten mesater te ponderuar jo me pak se 7 (shtate).
- b. Kriteret e percaktuara ne nenin 76/4 dhe ne nenin 76/5 te Ligjit Nr.80/2015.
- c. Renditja e aplikanteve behet sipas perputhshmerise me programin Bachelor ne Inxhinieri Elektrike profili Energjitikë dhe me tej sipas notes mesatare te ponderuar.
- d. Mund te pranohen studente nga programe studimi ne Inxhinieri Elektrike nga institucione te tjera te arsimit te larte brenda dhe jashte vendit, te akredituara, kur pas procesit te ekuivalentimit, perputhshmeria me programin Bachelor ne Inxhinieri Elektrike profili Energjitikë eshte jo me pak se 150 kredite.
- e. Nese nuk plotesohet numri minimal per hapjen e programit sipas kritereve te mesiperme, me Propozim te Departamentit dhe Vendim te Dekanatit mesatarja pranohet me e ulet.

4. Master Profesional në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizim Industrie

5. Master Profesional në Inxhinieri Mekatronike


ka vendodur këto kritere:

- a. Kriteret e percaktuar ne nenin 76/4 dhe ne nenin 76/5 te Ligjit Nr.80/2015.
- b. Renditja e kandidatëve bëhet sipas notës mesatare të ponderuar.
- c. Kanë përparësi studentët që kanë diplomë Bachelor me të njëjtin emërtim, më tej nga diplomat Bachelor që mbështet Departamenti i Automatikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe fakultetet e tjera të UPT.
- d. Pranohen edhe studentë nga programe studimi ekuivalente në institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit të akredituara.

6. Master Profesional në Elektroenergjitikë

ka vendodur këto kritere:

- a. Të ketë përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Elektrike.





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

- b. Renditja e aplikantëve bëhet sipas përputhshmërisë me programin Bachelor në Inxhinieri Elektrike profili Energjistikë dhe me tej sipas notës mesatare të ponderuar.
- c. Pranohen studentë nga programe studimi ekuivalente nga institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, të akredituara, kur pas procesit të ekuivalentimit, përputhshmëria me programin Bachelor në Inxhinieri Elektrike profili Energjistikë është jo më pak se 150 kredite.

D. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike me programet e studimit:

1. Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, profili Konstruksion Makinash dhe Mjete Lëvizëse;
2. Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, profili Energjetikë;
3. Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, profili Prodhim dhe Menaxhim Industrial;
4. Master i Shkencave në Inxhinieri Tekstili dhe Mode;
5. Master i Shkencave në Inxhinieri Materiale, profili Materiale;
6. Master i Shkencave në Menaxhim Energjie;
7. Master i Shkencave në Inxhinieri Ekonomike;
8. Master Profesional në Inxhinieri Mekanike, profili Energjistikë;
9. Master Profesional në Inxhinieri Transporti;
10. Master Profesional në Inxhinieri Materiale.

ka vendodur këto kritere:

- a. Profili i diplomës Bachelor. Prioritet do të kenë aplikantët që kanë mbaruar studimet e tyre Bachelor në FIM.
- b. Mesatare e ponderuar në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor.
- c. Preferencës për programin e studimit të përzgjedhur nga aplikanti.

E. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike me programet e studimit:

1. Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike

- 1) Kanë të drejtë të aplikojnë për programin e studimit të ciklit të dytë *Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike*, kandidatët që:
 - a. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

- studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose
- b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi, kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- 2) Në studimet e ciklit të dytë *Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike*, pranohen:
- a. pa njohuri plotësuese,
studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
- “Bachelor” në Inxhinieri Matematike;*
 - Diplomë e Niveli të Parë në Inxhinieri Matematike;*
 - nga fusha të njëjta ose të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%; ku përfshihen diplomat:
 - *Bachelor në Inxhinieri Fizike, FIMIF-UPT*
 - *Bachelor në Matematike, FSHN, UT*
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve shqiptare*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve të huaja*
- b. me plotësim të njohurive,
studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
- *“Bachelor” ose Diplomë e Niveli të Parë nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:*
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve shqiptare;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve të huaja.*

Plotësimi me njohuritë bëhet në përputhje me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies së UPT-së dhe me rregulloren e programit të studimit.

- 3) Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

- 4) Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin 2024-2025, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.

2. Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Inxhinier Fizike

- 1) Kanë të drejtë të aplikojnë për programin e studimit të ciklit të dytë *Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Inxhinier Fizike*, kandidatët që:
- kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përfaqëta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose
 - jane diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- 2) Në studimet e ciklit të dytë *Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike*, pranohen:
- pa njohuri plotësuese, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
 - “Bachelor”* në *Inxhinieri Fizike*;
 - Diplomë e Niveli të Parë* në *Inxhinieri Fizike*;
 - nga fusha të njëjta ose të përfaqëta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%; ku përfshihen diplomat:
 - *Bachelor* në *Inxhinieri Matematike, FIMIF-UPT*
 - *Bachelor* në *Fizikë, FSHN, UT*
 - *Bachelor* në disa fakultete inxhinierike të UPT-së
 - *Bachelor* në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare
 - *Bachelor* në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja
 - me plotësim të njohurive, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë *“Bachelor”* ose *Diplomë e Niveli të Parë* nga fusha të përfaqëta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

- *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;*
- *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare;*
- *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja.*

Plotësimi i njohuritë formuese bëhen në përputhje me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies së UPT-së dhe me rregulloren e programit të studimit.

- 3) Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- 4) Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin 2024-2025, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.

3. Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Fizikan Mjekësor

- 1) Kanë të drejtë të aplikojnë për programin e studimit të ciklit të dytë *Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Fizikan Mjekësor*, kandidatët që:
 - a. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose
 - b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- 2) Në studimet e ciklit të dytë *Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike*, pranohen:
 - a. pa njohuri plotësuese,
studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
 - i. “*Bachelor*” në *Inxhinieri Fizike*;
 - ii. *Diplomë e Niveli të Parë* në *Inxhinieri Fizike*;



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

iii. nga fusha të njëjta ose të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%; ku përfshihen diplomat:

- *Bachelor në Inxhinieri Matematike, FIMIF-UPT*
- *Bachelor në Fizikë, FSHN, UT*
- *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së*
- *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare*
- *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja*

b. me plotësim të njohurive,

studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë “*Bachelor*” ose *Diplomë e Niveli të Parë* nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:

- *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;*
- *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare;*
- *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja.*

Plotësimi i njohuritë formuese bëhen në përputhje me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies së UPT-së dhe me rregulloren e programit të studimit.

- 3) Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “*Master i shkencave*” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i çertifikatës së fituar. Nëse individit ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- 4) Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin 2024-2025, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.

4. Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh

- 1) Kanë të drejtë të aplikojnë për programin e studimit të ciklit të dytë Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh, kandidatët që:



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

- a. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose
 - b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- 2) Në programin e studimit të ciklit të dytë *Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh*, pranohen:
- a. pa njohuri plotësuese, studentët që kanë marrë Diplomë Universitare të ciklit të parë “*Bachelor*” (ose Diplomë e Niveli të Parë) në Inxhinieri Matematike.
 - b. me plotësim të njohurive, studentë që kanë marrë Diplomë Universitare të ciklit të parë “*Bachelor*” (ose Diplomë e Niveli të Parë) në:
 - Inxhinieri Fizike (FIMIF, UPT)
 - Inxhinieri Elektrike (FIE të tre drejtimet, UPT)
 - Inxhinieri Elektronike (FTI, UPT)
 - Inxhinieri Informatike (FTI, UPT)
 - Inxhinierine e Telekomunikacionit (FTI, UPT)
 - Inxhinieri Gjeoinformatikë (FGJM, UPT)
 - Fizikë (FSHN, UT)
 - Matematikë (FSHN, UT)
- 3) Studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë: “*Bachelor*” ose *Diplomë e Niveli të Parë* nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
- *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;*
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të universiteteve shqiptare;*
 - *Bachelor në disa fakultete të universiteteve publike apo private me drejtim në fusha të përafërta*
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të universiteteve të huaja.*





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Plotësimi me njohuritë formuese bëhet në përputhje me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies së UPT-së dhe me rregulloren e programit të studimit.

- 4) Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin akademik 2024-2025, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.

F. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me programet e studimit:

1. Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Trajtim Uji

Në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Trajtim Uji”, kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Kriter pranimi në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Trajtim Uji”, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj miratohet nga SAUPT, në përputhje me udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2. Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Energjetikë

Në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Energjetikë”, kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Kriter pranimi në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Trajtim Uji” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj miratohet nga SAUPT, në përputhje me udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, ku përcaktohet dhe tipi i



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

3. Master i Shkencave në Inxhinieri Hidroteknikë

Në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Hidroteknikë”, kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Kriter pranimi në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Hidroteknikë”, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj miratohet nga SAUPT, në përputhje me udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

4. Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeodezi

Në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeodezi”, kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Kriter pranimi në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeodezi”, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj miratohet nga SAUPT, në përputhje me udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

5. Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Infrastrukturë e transportit

Në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Infrastrukturë e Transportit”, kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati I diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Kriter pranimi në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Infrastrukturë e Transportit”, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj miratohet nga SAUPT, në përputhje me udhëzimin e ministries përgjegjëse për arsimin e lartë, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

6. Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Gjeoteknikë

Në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Gjeoteknikë”, kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati I diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Kriter pranimi në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Gjeoteknikë”, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj miratohet nga SAUPT, në përputhje me udhëzimin e ministries përgjegjëse për arsimin e lartë, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

7. Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturist

Në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturist” kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Kriter pranimi në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturist”, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj miratohet nga SAUPT, në përputhje me udhëzimin e ministries përgjegjëse për arsimin e lartë, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

8. Master Profesional në Inxhinieri Mjedisi

Në programin e studimit “Master Profesional në Inxhinieri Mjedisi”, kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.


9. Master Profesional në Inxhinieri Hidroteknike

Në programin e studimit “Master Profesional në Inxhinieri Hidroteknike”, kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

10. Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi

Kuotat dhe kriteret e veçanta për pranimin të studentëve në programin e studimit “Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi”, bëhen me vendim të SAUPT, mbështetur në propozimet e Departamentit të Gjeodezisë, miratimin e FIN dhe të BAUPT, në përputhje me standardet shtetërore, kapacitetet akademike dhe ato infrastrukturorë.

Në programin e studimit “Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi”, kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.



G. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me programet e studimit:

1. Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE


Në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike” mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë:

- I. Diplomë të ciklit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni ose Inxhinieri Informatike të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga departamenti. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti bazuar në kuotat e pranimit të miratuara nga MAS, parimit të meritës dhe preferencës së kandidatit si dhe prioriteteve të vendosura nga departamenti. Lista e fituesve shpallet në ambientet e FTI dhe faqen elektronike të FTI;
- II. Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

- 1) Regjistrohen fillimisht, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni, të fituar pranë DET-FTI, UPT. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, *preferohet* të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (*vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh*) me mesatare më të ulët;
- 2) Në rast se, pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplome Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor në Inxhinieri Informatike. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, *preferohet* të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (*vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh*) me mesatare më të ulët;
- 3) Në rast se, edhe pas plotësimit të pikës 2, të nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor (ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Elektronike) të fituar në UPT ose jashtë saj, sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, e cila *preferohet* të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00).

2. Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike” mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë:

- I. Diplomë të ciklit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Informatike ose Inxhinieri Telekomunikacioni , Inxhinieri Elektronike të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjajshme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga Departamenti. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti bazuar në kuotat e pranimit të miratuara nga MAS, parimit të meritës dhe preferencës së kandidatit si dhe prioriteteve të vendosura nga departamenti. Lista e fituesve shpallet në ambientet e FTI dhe faqen elektronike të FTI;
- II. Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.


Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

- 1) Renditen fillimisht, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë DII-FTI, UPT. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00).
- 2) Renditen të dytët në vijim të pikës 1, të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë ≥ 7.00 .
- 3) Renditen të tretët në vijim të pikës së 2-të të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor ose ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Informatike të fituar në UPT ose jashtë saj, sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00).

3. Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni

Në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni” mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë:

- I. Diplomë të ciklit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Informatike të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjajshme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga departamenti. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

bazuar në kuotat e pranimi të miratuara nga MASH, parimit të meritës dhe preferencës së kandidatit si dhe prioriteteve të vendosura nga departamenti. Lista e fituesve shpallet në ambjentet e FTI dhe faqen elektronike të FTI;

- II. Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.


Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

- 1) Rregjistrohen fillimisht, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni ose Inxhinieri Elektronike, të fituar pranë DET-FTI, UPT. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, *preferohet* të jete më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (*vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh*) me mesatare më të ulët.
- 2) Në rast se, pas pranimi të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplome Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor në Inxhinieri Informatike. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, *preferohet* të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (*vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh*) me mesatare më të ulët;
- 3) Në rast se, edhe pas plotësimit të pikës 2, të nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor (ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Telekomunikacioni) të fituar në UPT ose jashtë saj, sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, e cila *preferohet* të jete më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00).

4. Master Profesional në Teknologji Informacioni

Në programin e studimit “Master Profesional në Teknologji Informacioni”, mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë:

- I. Diplomë të Ciklit të Parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi) në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Informatike, të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisionet ad hoc që ngrihen nga departamenti;





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

- II. Gjithashtu mund të aplikojnë për regjistrim në programin e studimit *Master Profesional në Teknologji Informacioni* kandidatet që kanë përfunduar kryesisht studimet e ciklit të parë në fushat e inxhinierise, në fushën e teknologjisë së informacionit, art-media-design, në fushat e shkencave të natyrës, të shkencave humane apo atyre social-ekonomike, administrimit, menaxhimit apo jurisprudencës me orientim kriminel kibernetik.
- III. Pavarësisht nga diploma bachelor, DET (FTI-UPT) mund të organizojë testime paraprake/pranuese për kandidatet për studimet *Master Profesional në Teknologji Informacioni*, si dhe intervista. Përparësi do të kenë për t' u regjistruar gjithashtu edhe të gjithë ata kandidatë që punojnë apo kanë eksperiencë punë në tregun/industrinë e komunikimeve elektronike dhe/ose teknologjisë së informacionit.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

- 1) Regjistrohen fillimisht, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT.
- 2) N.q.s. pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, kandidatët që i përkasin Pikes I, Neni 9 (kandidatët që zotërojnë diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj).
- 3) N.q.s. pas plotësimit të Pikës I, të Nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët që i përkasin Pikes II, Neni 9, sipas diplomës Bachelor të fituar, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor dhe vlerësimeve të komisionit ad-hoc të ngritur nga DET.
- 4) N.q.s. edhe pas plotësimit të Pikës II, të Nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim kandidatët sipas përcaktimeve të Pikes III të Nenit 9, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor dhe vlerësimeve të komisionit ad-hoc të ngritur nga DET.

5. Master Profesional në Inxhinieri Informatike

Në programin e studimit "Master Profesional në Inxhinieri Informatike", mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë:

- I. Diplomë të Ciklit të Parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, ose diploma të ngjashme të fituara në Universitetin Politeknik të Tiranës ose jashtë tij. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad hoc që ngrihet nga departamenti.





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

- 1) Regjistrohen fillimisht, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT.
- 2) Në rast se, pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët e FTI që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni.
- 3) Në rast se, pas plotësimit të pikës 2, të nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor të fituar në UPT të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.
- 4) Në rast se, edhe pas plotësimit të pikës 3, të nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor të fituar jashtë UPT, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.

